REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC
28.04.2017

P.nr.273/17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**-Departamenti i përgjithshëm. Divizioni Penal. gjyqtari individual Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në lëndën penale kundër të pandehurit [redacted] nga fsh. [redacted] komuna Shtimes. i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1877-4/16, të dt. 25.01.2017. për veprën penale falsifkimi i dokumenteve nga neni 398, par. 1, të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, dënim me gjobë, gjykata me datë.08.03.2017, mori këtë:

## A K T GJ Y K I M

**PRANOHET,** kërkesa e PTH në Ferizaj PP/II.nr1877-4/16, të dt.25.01.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

## URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri [redacted] nga fsh [redacted] komuna e Shtimës, i lindur me datë [redacted], në të njëjtin vend, nga i ati [redacted] dhe ëma [redacted] e gjinisë [redacted] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i gjendjes së varfër ekonomike.

## ËSHTË FAJTORË

Se me datë.15.06.2016, rreth orës 12:10, në rrugën "Tahir Sinani" në Shtime, gjatë kontrollimit nga ana e policisë është konstatuar se ka përdorur dokumentin e falsifikuar dhe atë targat e regjistrimit me nr. [redacted] të Shtetit të Zvicrës, në automjetin e markës "Florina Pikap", me numër të shasisë [redacted] e të cilat i ka përdor gjatë drejtimit të këtij automjetit, edhe pse e ka ditur se të njëjtat janë të falsifikuara.

**Me çka ka kryer veprën penale falsifkimi i dokumenteve nga neni 398, par 1, të KPRK-së.**

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,41,46,73, të KPK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

## GJ Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPK-së, i njëjti do ti shëndrrohet në dënim burgu për të pandehurin ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1 (një) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1877-4/16, e datës.25.01.2017, e ka akuzuar të pandehurin [redacted] për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398, par 1, të KPRK-së dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në bazë të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Vërtetimi mbi marrjen e përkohshme të gjësendeve, të datës 15.06.2016, raporti fillestar i incidentit me numër [redacted] Fiat Fiorino 1.4, ZFA [redacted] librezën e qarkullimit [redacted] 978, deklarata e të pandehurit e dhënë në polici më datë 07.07.2016, vërtetimi mbi dorëzimin e veturës nr.2016-AU-174, i datës 15.06.2016, si dhe fotografitë e veturës "Fiat Fiorino", vërtetoj se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht e vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 dhe 451, të KPPK-së

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**
**P.nr.273/17, më datë.08.03.2017**

**Skretarja juridike** — **Gjyqtari Individual**

**Makfire Reçica** — **Faton Ajvazi**

**KËSHILLË JURIDIKE:**
Kudër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.